



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 16 Prot.

Tiranë, më datë 10.01.2025

VENDIM

Nr. 15, datë 10.01.2025

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 10.01.2025:

VENDOSI

1. Miratimin e Raportit të potencialit arkeologjik hartuar në kuadër të projektit “Zgjerimi i rrugës së Ksamilit”, Bashkia Sarandë, me zhvillues **Autoriteti Rrugor Shqiptar**;
2. Miratohet gjurma e projektit, e cila shtrihet në Zonën Mbrojtëse të Pasurisë Botërore Butrint;
3. Të rishikohet gjurma e projektit, e cila shtrihet Brenda hapsirës të Pasurisë Botërore Butrint dhe gjurma e rishikuar të paraqitet për shqyrtim dhe vendimmarrje në KKTKM;
4. Projekti të përcillet për mendim në UNESCO;
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
6. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Sokol ISMAILI

